



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr.265, Datë 28.12.2020

“PËR

MIRATIMIN E “RREGULLAVE PËR MONITORIMIN E TREGUT

TË GAZIT NATYROR, NË SHQIPËRI”.

Në mbështetje të nenit 16, pika 24, të Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” i ndryshuar, të nenit 16, të ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, me nr.142/8prot, datë 24.12.2020 “Për miratimin e Rregullave për monitorimin e tregut të gazit natyror” në Shqipëri.

Konstatoi se:

- Me vendimin nr. 164 datë 22.10.2020, bordi i ERE-s ka vendosur, “Fillimin e procedurës për shqyrtimin e draftit të “Rregullave për monitorimin e tregut të gazit natyror” në Shqipëri.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje u bënë publikimet në faqen e web-it të ERE-s, njoftimi në median e shkruar me shkresën e ERE nr.62/31 prot datë 29.10.2020 si dhe njoftimi për botimin në Fletoren zyrtare me shkresën e ERE nr.68/37 prot., datë 03.11.2020, botuar ne Fletoren zyrtare Nr.195, datë 11.11.2020.
- Për të marrë opinionet e palëve të interesuara referuar vendimit të Bordi i ERE-s, me nr.164, datë 22.10.2020, ERE me anë të shkresës nr.1161 prot., datë 2.11.2020 i’u drejtua Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Autoritetit të Konkurrencës (AK), Anio Oil & Gas” sh.p.k, “Phoenix Petroleum” sh.a., “Albgaz” sh.a., “C.G.C” sh.p.k., “Balkgaz”sh.p.k., “TAP AG Albania” sh.p.k., Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë Elektrike me qëllim që palët e interesuara të shprehnin, brenda 30 ditëve, opinionet dhe koment e tyre.
- Në përfundim të afateve me qëllim dhënien apo marrjen e mendimeve ose propozimeve në lidhje me draftin e “Rregullave për monitorimin e tregut të gazit natyror”, rezulton se Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me shkresën nr.7788/1 prot., datë

16.12.2020, protokolluar në ERE me nr.1161/2 Prot., datë 17.12.2020, ka shprehur dakortësinë e saj.

- Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, me anë të një email-i zyrtar më datë 09.12.2020 parashtron disa komente dhe pyetje për nenet **Neni 1, pika 5; Neni 2, pika 1, shkronja d); Neni 2, pika 3; Neni 4, pika 1; Neni 5, pika 1; Neni 5, pika 2; Neni 10, pika 2; Neni 12, pika 4; Neni 12, pika 5; Neni 14; Neni 20, pika 1**; te cilat u shqyrtuan në relacionin përkatës.
- Nuk rezulton të ketë asnjë koment, vërejtje apo sugjerim nga palët e tjera te interesit në lidhje me përmbajtjen e draftit të Rregullave për monitorimin e tregut të gazit natyror me të cilin bordi i ERE ka filluar procedurën.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e “Rregullave për Monitorimin e Tregut të Gazit Natyror” në Shqipëri.
2. Hyrja në fuqi e “Rregullave për Monitorimin e Tregut të Gazit Natyror” do të jetë 1 korrik 2021.
3. Drejtoria e Gazit Natyror , të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI